



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 471

Prishtinë, Dt. 20/01/2026

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Kimi Analitike & Kimi Mjedisore
Titulli	Analiza e gjurmëve të karbonit në Kosovë nga sektori energjetik
Kandidatja	Festina Breznica Januzi
Mentori	Prof. Ass. Liridon Berisha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 30.05.2025 Vendimi nr. 1679

Vlerësimi i dorëshkrimit

Dorëshkrimi i temës së masterit me titull "**Analiza e gjurmëve të karbonit në Kosovë nga sektori energjetik**" është shkruar në gjuhën shqipe dhe struktura e tij i përgjigjet standardeve akademike të një pune shkencore të nivelit master. Struktura e tij përfshin pjesën e përgjithshme, hyrje, karboni, sektori i energjisë elektrike në Kosovë, metodologjia e hulumtimit dhe burimet e të dhënave, përfundimet, rezymenë në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe literaturën. Punimi trajton një tematikë me rëndësi të veçantë shkencore dhe mjedisore në analizën e gjurmëve të karbonit në Kosovë nga sektori energjetik.

Në kapitullin e parë, është paraqitur një pasqyrë e qartë dhe e plotë e problematikës dhe rëndësisë së analizës së gjurmëve të karbonit. Është paraqitur edhe qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia e cila është përdorur dhe burimet e informatave që janë përdorur në realizimin e hulumtimit.

Kapitulli i dytë përshkruan mekanizmin e efektit serë nga gazërat që ndodhen në atmosferë dhe përshkruhen qartë metodat e llogaritjeve që përdoren për efektin në ngirtje të temperaturës në varësi të parametrevë të ndryshëm.

Kapitulli i tretë paraqet karbonin si burim energjie dhe njëkohësisht edhe si element kyç në këtë hulumtim duke dhënë informata nga literatura ekzistuese për ciklin e karbonit dhe konceptin e gjurmëve të karbonit si dhe matjen e tij.

Në kapitullin 4 është përshkruar sektori energjetik dhe me theks të veçantë në Kosovë, përfshirë edhe ndikimin në mjedis. Gjithashtu është pasyruar edhe sistemi i transmetimit, linjat interkonektive nga sistemi rajonal, në sistemin elektroenergjetik të Kosovës.

Në kapitullin e 5 është përshkruar metodologjia e hulumtimit ku janë dhënë burimet e informatave përfshirë sektorin e burimit të energjisë dhe transmetimit. Janë analizuar të dhënat në mënyrë të detajuar për secilin sektor në ciklin energjetik.

Përfundimet e dorëshkrimit janë të qarta, të argumentuara dhe të mbështetura në informata zyrtare. Ato reflektojnë plotësimin e objektivave të studimit dhe kandidatja ka arritur të demonstrojë kompetencë në hulumtim dhe aftësi për interpretimin shkencor të të dhënave. Përfundimet kanë vlerë teorike dhe praktike, duke ofruar një kontribut të rëndësishëm në monitorimin e gjurmëve të karbonit në Kosovë.

Dorëshkrimi mbështetet në literaturë të pasur dhe të përditësuar, duke treguar aftësi të mirë të kandidatës në mbledhjen dhe analizimin e informacioneve shkencore relevante.

Në përmbledhje, dorëshkrimi i kandidatës Festina Breznica Januzi reflekton angazhim të lartë akademik, rigorozitet shkencor dhe qasje të strukturuar në hulumtimin e gjurmëve të karbonit. Tema ka rëndësi të veçantë mjedisore dhe kontributi i saj aplikativ e bënë punimin të vlefshëm si për komunitetin shkencor, dhe institucionet monitoruese të mjedisit.

Duke marrë parasysh përmbajtjen e punimit, qasjen shkencore dhe metodologjike të ndjekur, si dhe analizën dhe diskutimin e rezultateve të arritura, komisioni vlerësues konstaton se punimi me titull **“Analiza e gjurmëve të karbonit në Kosovë nga sektori energjetik”** i plotëson të gjitha kriteret akademike dhe shkencore të kërkuara për punim masteri. Në këtë kontekst, komisioni i propozon Këshillit të Departamentit të Kimisë lejimin e mbrojtjes publike të punimit dhe dhënien e gradës **“Master i Shkencave në Kimi”** për kandidaten **Festina Breznica Januzi**.

Prishtinë, 18/02/2026

Komisioni

1. M. Daci
Prof. Majlinda Daci, kryetare
2. T. Arbnesi
Prof. Tahir Arbneshi, anëtar
3. L. Berisha
Prof. Ass. Liridon Berisha, anëtar